

VENDIM
Nr. 872, datë 24.12.2019

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 673, DATË 22.11.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR RIORGANIZIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 673, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun II bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijojnë:

a) në pikën 5 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

i. shkronja “ë” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ë) ofron shërbimin e nënshkrimit elektronik, vulën elektronike, certifikatën elektronike për organet e institucionet e administratës publike dhe subjektet private, sipas tarifave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave. Përcaktimi i tarifave sipas kësaj shkronje bëhet me propozimin e AKSHI-t dhe miratimin e ministrit përgjegjës për financat dhe ekonominë.”;

ii. në shkronjën “j”, fjalët “lidh kontrata” hiqen;

iii. pas shkronjës “j” shtohet shkronja “k”, me këtë përmbajtje:

“k) përgjigjet për ngritjen, mirëmbajtjen e sistemeve dhe të aplikacioneve të teknologjisë së informacionit e komunikimit për infrastrukturën e qendëruar dhe infrastrukturën TIK, për njësitë e qeverisjes vendore (NJQV) (bashkitë), me kërkesë të tyre.”;

b) pas pikës 5 shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“5/1 Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit është pika hyrëse e Rrjetit të Shërbimeve Trans evropiane për Telematikën ndërmjet Administratave, në Republikën e Shqipërisë, e cila ushtron kompetencat kryesore, si më poshtë vijon:

a) është përgjegjës për t’iu përgjigjur përdoruesve të *domain*-it të saj lokal, të cilët nuk janë të autorizuar të kontaktojnë drejtpërdrejt me mbështetjen qendrore të Rrjetit të Shërbimeve Trans evropiane për Telematikën ndërmjet Administratave;

b) merr masa për të lehtësuar ndërveprimin ndërmjet *domain*-it evropian dhe *domain*-it lokal;

c) posedon hapësirë të mjaftueshme dhe siguron të gjitha mjetet logjistike për komunikimin me rrjetin TESTA;

ç) merr të gjitha masat e nevojshme të sigurisë për funksionimin operacional të *domain*-it;

d) ndjek e zbaton detyrimet reciproke të përcaktuara në memorandumin e mirëkuptimit, që do të nënshkruhet për këtë qëllim me Drejtorinë e Përgjithshme të Informatikës në Komisionin Evropian.”;

c) në pikën 6 bëhen këto ndryshime:

i. shkronja “d” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“d) ofron shërbimet e autentifikimit, të nënshkrimit elektronik, të vulës elektronike dhe të certifikatës elektronike për organet dhe institucionet e administratës publike e subjektet private.”.

ii. në shkronjën “e”, fjalët “... sipas tarifave të miratuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat dhe ekonominë ...” zëvendësohen me fjalët “... sipas tarifave të përcaktuara në vendimin

e Këshillit të Ministrave. Përcaktimi i tarifave sipas kësaj shkronje bëhet me propozimin e AKSHI-t dhe miratimin e ministrit përgjegjës për financat dhe ekonominë ...”.

2. Në kreun III bëhen këto ndryshime:

a) në pikën 14, fjalët “... bordi për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (BTIK) ...” zëvendësohen me “... Këshilli Kombëtar për Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (KKTIK) ...”;

b) në pikën 15, emërtimi “BTIK” zëvendësohet me “KKTIK”.

3. Në listën nr. 1, “Katalog shërbimesh”, bashkëlidhur vendimit, pas shërbimit “vulë elektronike” shtohet “certifikatë elektronike”, sipas shtojcës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe të gjitha institucionet e organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

SHTOJCA

Certifikata elektronike	Certifikatë elektronike X.509v3	AKSHI	Administrata publike, subjektet/bizneset
--------------------------------	---------------------------------	-------	--